

SAULI

MREKULLIA NË MES TË RRUGËS

TREGIMI NGA CARINE MACKENZIE
ILUSTRIMET NGA FRED APPS



© Carine Mackenzie, 1997

Reprinted 2000, 2002, 2004, 2007, 2010, 2015

Published by Christian Focus Publications, Geanies House,
Fearn, Tain, Ross-shire, IV20 1 TW, Scotland, U.K.

www.christianfocus.com

Përkthyer në gjuhën shqipe nga ZGG-ALBANIA, 2019

Përkthyer nga: Migena Ramaj Adamou

Redaktuar nga: Mirela Zefi

Koordinatorë: Willemien van Schothorst

Sauli lindi në Tars, një vend që sot quhet Turqi. Prindërit e tij ishin judenj dhe Sauli u rrit duke mësuar ligjin e Perëndisë deri në detajet më të imëta.

Kur ishte i ri, prindërit e dërguan në Jerusalem për të studiuar tek mësuesi i famshëm, Gamalieli. Ai ishte nxënës i zellshëm dhe jetonte me drejtësi.








Kur u rrit, u bë një rabi, mësues i ligjit hebre. Ai mësoi edhe zanatin e ndërtimit të çadrave. Sauli ishte njeri i zgjuar.


Ai e respektonte dhe e mbante me zell ligjin, por i urrente besimtarët e krishterë, të cilët po rriteshin gjithnjë e më shumë në numër. Ata ishin njerëz që besonin te Zoti Jezus Krisht dhe besonin se Ai vdiq që të paguante për mëkatet e tyre. I ndiqnin e zbatonin mësimet e Tij.

Sauli bëri çdo gjë që kishte në dorë t'i dëmtonte këta njerëz.





Kur një turmë njerëzish po vrisnin me gurë Stefanin, vetëm sepse ai kishte shpallur Jezusin, Sauli ishte aty dhe po e ndiqte me sy të gjithë skenën, duke miratuar atë që po bënin. Madje-madje, ruante edhe gjërat e tyre personale. Ai e urrente Jezusin dhe i urrente të gjithë ata që e ndiqnin Atë. Por një ditë, Sauli do të ndryshonte!





Me një letër zyrtare që i jepte liri veprimi, Sauli u nis për në Damask. Plani i tij ishte të gjente çdo burrë a grua që ndiqte Zotin Jezus dhe t'i arrestonte. Pastaj t'i kthente në Jerusalem që të ndëshkoheshin, madje edhe të vriteshin. Zemra e Saulit ishte plot me urrejtje.



Ndërsa po i afrohej gjysmës së rrugës për në Damask, papritur një dritë e fortë vetëtiu nga qielli. Sauli ra përtokë i tmerruar. Ai dëgjoji një zë që i thoshte: "Saul, Saul, pse po më persekuton?"

Sauli u përgjigj: "Kush je, Zot?"







Zëri iu përgjigj: "Unë jam Jezusi i Nazaretit që t'i përndjek. Është e rrezikshme për ty të luftosh kundër fuqisë Sime."

Njerëzit që ishin me Saulin e panë dritën dhe u hyri frika.

Edhe Sauli po dridhej nga frika.



“Çfarë do që të bëj Zot?” pyeti ai.

“Ngrihu dhe shko në qytetin e Damaskut dhe aty do të tregojnë çfarë të bësh” iu përgjigj Zoti.





Sauli u ngrit nga toka. Kur hapi sytë, zbuloi që nuk mund të shikonte. Drita e shkëlqyeshme e kishte verbuar.



E kapën për dore dhe e drejtuan përgjatë gjithë pjesës së mbetur të rrugës për në Damask. E çuan në shtëpinë e Judës, në rrugën që quhej "E drejtë".







Për tri ditë Sauli as nuk hëngri dhe as nuk piu gjë. Ai ishte tërësisht i verbër. Ai kaloi kohë duke iu lutur Perëndisë. Perëndia i dëgjo i lutjet e tij dhe dërgoi një njeri që ta ndihmonte.

Anania, ishte një ndjekës i Zotit Jezus që jetonte në Damask. Perëndia i foli në një vizion.

“Shko në rrugën “E drejtë”, tek shtëpia e Judës dhe kërko një burrë të quajtur Saul nga Tarsi. Ai është atje duke u lutur.”

Anania ishte në ankth. “Zot, kam dëgjuar për atë burrë” tha ai. “Ai ka lënduar shumë nga besimtarët e Tu në Jerusalem. Madje ka ardhur këtu me nje leje të posaçme për t’i arrestuar ata që do të të ndjekin Ty.”

“Shko!” i tha Zoti sërish, “sepse atë e kam zgjedhur që t’u predikojë për mua njerëzve të të gjitha kombeve.”

Anania e gjeti Saulin aty ku Perëndia i kishte thënë.







“Vëlla Saul”, i tha ai, “Zoti Jezus, i Cili të foli gjatë rrugës kur po vije këtu. Më ka dërguar që ti të mund të shikosh përsëri dhe të mbushesh me Frymën e Shenjtë.”

Menjëherë diçka si luspa ranë nga sytë e Saulit dhe atij iu rikthye shikimi.



Sauli u pagëzua për të treguar që tashmë ishte besimtar i Zotit Jezus Krisht dhe se kishte filluar një jetë të re. Pastaj hëngri një vakt të mirë që i dha forcë.

Besimtarët në Damask e mirëpritën Saulin. Ai predikoi për Jezusin në sinagoga duke treguar lajmin e mirë që Jezusi është Biri i Perëndisë.





Sauli predikoi aq fuqishëm në Damask, saqë judenjtë u zemëruan shumë. Ata thurën plane me njëri-tjetrin se si ta vrisnin atë. Sauli dëgjoi për këtë plan të lig dhe vendosi të arratisej. Judenjtë vunë roje në të gjitha portat e qytetit; ata donin të siguroheshin që do ta zinin.

Besimtarët (tani miq të Saulit) bënë një plan të mirë. Ata morën një kosh të madh. Sauli hyri brenda koshit dhe miqtë e tij e ulën me kujdes nga muret me anë të litarëve dhe e nxorën jashtë qytetit. Në këtë mënyrë Sauli u arratis.







Ndërkohë në Jerusalem, ndjekësit e Jezusit u frikësuan kur morën vesh që Sauli po përpiqej të bashkohej me ta. Ata nuk mund të harronin sa mizor kishte qenë ai më përpara në Jerusalem. E kishin të vështirë ta besonin që ky njeri tashmë kishte ndryshuar.



Një njeri i mirë, i quajtur Barnaba, u ngrit dhe foli për Saulin. "Ai ka ndryshuar me të vërtetë. Zoti Jezus iu shfaq rrugës për në Damask. Oë nga ai moment, ai e ka shpallur me guxim Zotin atje."

Pastaj të krishterët e pranuan me gëzim atë, si mikun dhe vëllanë e tyre.





Çfarë ndryshimi në jetën e Saulit! Çfarë e bëri këtë ndryshim? Takimi dramatik me Zotin Jezus Krisht ishte pika e kthesës në jetën e Saulit. Sauli shkroi më vonë: "Jezus Krishti erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët, ndër të cilët unë jam i pari."

Jezusi edhe sot takohet me mëkatarët. Në Fjalën e Tij, Biblën, na thotë që edhe ne mund të marrim mëshirë dhe falje ashtu si Sauli, duke besuar vetëm në Jezusin.



MREKULLIA NË MES TË RRUGËS

Drita mahnitëse e ndaloi Saulin në rrugëtimin e tij. Kur Perëndia i foli, ai e dinte që jeta e tij nuk do të ishte kurrë më e njëjtë!

Mund të lexoni rreth Saulit në Bibël, në librin e Veprave të Apostujve.

LISTË BROSHURASH

1. Noeu | Plani i shpëtimit
2. Sara dhe Abrahami | Premtimi i mrekullueshëm
3. Jozefi | Ëndërrimtari i Perëndisë
4. Miriami | Sekretet e motrës së madhe
5. Sansoni | Fuqia e njeriut të fortë
6. Samueli | Djali i bindur
7. Davidi | Luftëtari trim
8. Jonathani | Miku besnik
9. Jobi | Miku durimmadh
10. Elia | Njeriu i mrekullive të Perëndisë
11. Ezekia | Zgjedhjet e mbretit
12. Jeremia | Një burrë me një mesazh
13. Danieli | Princi që lutej
14. Jezusi | Fëmija i premtuar
15. Jezusi është gjallë | Historia mahnitëse
16. Sauli | Mrekullia në mes të rrugës
17. Pali | Udhëtime me aventura
18. Barnaba | Zemërdhënësi



Ejani tek Unë



ZGG-Albania

(Misioni i Bashkësive të Reformuara)

